

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.01.2023*

12.01.2023
Ora, 11:05

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shpalljen e rezultatit të shortit për caktimin e partisë që do të propozojë anëtarin e shtatë të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ-ve), në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :


- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,**
 Z. E. Meta, Znj. V. Ballgjini
- **Parti Politike:**
- **OJQ: KRIK**

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve! Seanca e sotme ka në rend dite këto çështje: Projektvendimin “Për shpalljen e rezultatit të shortit për caktimin e partisë që do të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

Pika e dytë projektvendim “Për përdorimin e kodeve të sigurisë për pajisjen elektronike të identifikimit të zgjedhësve”.

Kemi dhe çështjen të shtyrë nga seanca e kaluar që ka të bëjë me projektvendimin Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, etj.. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës “Për shpalljen e rezultatit të shortit për caktimin e partisë që do të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.01.2023*


Z. Y. Merkaj: Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, përcakton në nenin 29, pika 1 të tij, rradhën e propozimit të anëtarit të shtatë, ku në gjysmën e KZAZ-ve ai propozohet nga partia e parë e shumicës parlamentare dhe në gjysmën tjetër nga partia e parë opozitës parlamentare. Gjithashtu me vendimin nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator janë përcaktuar rregullat e shortit për caktimin e partisë politike që propozon anëtarin e shtatë të KZAZ-së. Referuar nenit 29, të Kodit Zgjedhor anëtari i shtatë propozohet sipas kritereve objektive të bazuara në përzgjedhjen rastësore si dhe në shpërndarjen e barabartë në territorin zgjedhor. Në zbatim të vendimit nr. 5 të Komisionit Rregullator, janë përcaktuar dhe procedurat për organizimin në seancë publike të hedhjes së shortit ku për këtë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka njoftuar partitë politike për të marrë pjesë në seancën e shortit të ditës së sotme. Gjithashtu Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 6, datë 9.1.2023 ka përcaktuar se anëtari i shtatë do të propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga Partia Socialiste e Shqipërisë, kurse në gjysmën tjetër të KZAZ-ve nga Partia Demokratike. Procedura e shortit është si më poshtë:

- Emrat e partive janë të shënuar në dy shirita letre të cilat futen në gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njejtë në një enë transparente.

- Në dy shirita të tjerë janë shënuar KZAZ-të me numër tek dhe numër çift, të cilat futen në një gogël me peshë, ngjyrë dhe formë të njejtë, në një enë të dytë transparente.

Një përfaqësues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që në rastin konkret është Sara përzjen goglat dhe në enën e parë transparente tërheq goglën ku është shkruar emrin e partisë. Përfaqësuesi i partisë që del nga tërheqja e shiritit që në rastin konkret është Partia Socialiste i lind e drejta të tërheqë goglën në enën e dytë transparente. Në

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.01.2023*

mungesë të përfaqësuesit të Partisë Socialiste vazhdon procedura dhe tërheqjen e goglës e bën përfaqësuesja e administratës së KQZ-së.


Në KZAZ-të e numërtuara me numër çift, anëtari i shtatë propozohet nga Partia Socialiste. Në KZAZ-të me numër tek i takojnë Partisë Demokratike.

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Anëtari i shtatë në KZAZ-të e renditura me numëri çift, i takon Partisë Socialiste.

Në KZAZ-të e renditura me numër tek, anëtari i shtatë i KZAZ-ve i takon Partisë Demokratike për të paraqitur propozimin.

Vendimi nr. 11

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.01.2023*

12.01.2023
Ora, 11:10

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për përdorimin e kodeve të sigurisë për pajisjen elektronike të identifikimit të zgjedhësve”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**

2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. V. Ballgjini**


• **Parti Politike:**

• **OJQ: KRIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me projektvendimin “Për përdorimin e kodeve të sigurisë për pajisjen elektronike të identifikimit të zgjedhësve”.

Z. Y. Merkaj: Në bazë të nenit 99, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dërgon në Komisionet e Administrimit Zgjedhor materialet zgjedhore që përdoren nga këto komisione për administrimin e procesit zgjedhor, si dhe materialet zgjedhore për Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV) për administrimin e procesit të votimit në qendrën e votimit. Pëveç materialeve zgjedhore të listuara në këtë dispozitë, shkronja “dh” e pikës 2, të nenit 99 të Kodit Zgjedhor, parashikohet se KZAZ-ja dërgon dhe kodet e sigurisë të pajisura me “Bar Code” për pajisjet elektronike të identifikimit të zgjedhësve për të siguruar integritetin e materialit

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.01.2023*

zgjedhor të cilat do të përdoren për identifikimin e zgjedhësve dhe paprekshmërinë e tyre gjatë transportit në çdo qendër votimi. Karakteristikat e përgjithshme dhe të veçanta janë bashkëlidhur projektvendimit që do të shqyrtohet. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe listën me karakteristikat e kodeve të sigurisë, faleminderit!.

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Me pak fjalë, përtej asaj që prezantuat, qëllimi është që të rrisim integritetin dhe garancinë mbi paisjen elektronike të identifikimit të zgjedhësve nëpërmjet përdorimit të këtyre kodeve të sigurisë. Këto kode kanë elementë të karakterit teknik dhe fizik të tillë që e bëjnë të pamundur që dikush, një i tretë të ndërhyjë fizikisht në brendinë e kësaj paisje. Mirë dakord, e miratojmë projektaktin sipas draftit të propozuar, meqenëse dhe nga përfaqësuesit e partive politike nuk kemi pas propozime, apo rekomandime në lidhje me përmbajtjen e këtij projektakti.

Vendimi nr. 12

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.01.2023*

12.01.2023
Ora, 11:12

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, miratimin e formatit të standardizuar për raportimin financiar të partive politike gjatë vitit kalendarik, kontrollin, verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre, si dhe mënyrën e pagesës së audituesve ligjorë”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. V. Ballgjini**


• **Parti Politike:**

• **OJQ: KRIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, e prapambetura që ka të bëjë me projektvendimin “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, miratimin e formatit të standardizuar për raportimin financiar të partive politike gjatë vitit kalendarik, kontrollin, verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre, si dhe mënyrën e pagesës së audituesve ligjorë”.

Z. Y. Merkaj: Meqenëse ka qenë e shtyrë dhe kemi disa rekomandime nga KRIIK-u, kemi bërë një takim me përfaqësuesen e KRIIK -ut. Jemi duke vlerësuar

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.01.2023*

sugjerimet e tyre të cilat do të na i sjellin në mënyrë më të detajuar gjatë ditëve në vazhdim. Në këto rrethana, projekti nuk është gati ende, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Dakord, do të presim pasi të konsiderojmë edhe propozimet që ka sjellë Organizata e KRIIK në lidhje me këtë projektvendim. Nuk kemi ndonjë problem me afatin?

Z. Y. Merkaj: Jo!

Z. I. Celibashi: Dakord! Do të përpiqemi nëse e bëjmë gati për ditën e hënë, sepse do të lemë një mbledhje ditën e hënë. Çështje të tjera nuk kemi, seanca mbyllet, faleminderit, ditë të mbarë!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

